

URDHËR
Nr. 168, datë 12.3.2020

“PËR NDALIMIN/KUFIZIMIN E LËVIZJEVE ME MJETET E TRANSPORTIT”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, gërma “ç”, dhe “d” të Ligjit Nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, si edhe referuar udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e qarkullimit të mjeteve të transportit publik dhe privat, përfshirë automjetet private, brenda Tiranës dhe Durrësit dhe nga Tirana dhe Durrësi drejt zonave të tjera të vendit dhe anasjelltas, duke filluar nga ora 06:00 e datës 13.3.2020 deri në orën 24:00 të datës 15.3.2020.

2. Ndalimin e qarkullimit të mjeteve të transportit publik dhe privat, përfshirë automjetet private, në Shkodër, Lezhë, Elbasan, Lushnjë, Fier dhe Vlorë duke filluar nga ora 06:00 e datës 13.3.2020 deri në orën 24:00 të datës 15.3.2020.

3. Përfshirë nga rregulli i përcaktuar në pikën 1 dhe 2 të këtij urdhëri bëhet për autoambulancat, automjetet që kryejnë funksione shërbimi me funksion publik dhe ato që transportojnë mallra. Autorizimi për qarkullimin e autoambulancave, automjeteve që kryejnë funksione shërbimi shtetëror dhe ato që transportojnë mallra kryhet sipas udhëzimeve të Policisë së Shtetit.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor të cilët bashkëpunojnë me Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe Policinë e Shtetit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu